

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Sistemimi e plazheve.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45243500-7.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **4,156,998.87** (katërmilion e njëqindpesëdhjetegjashtëmijë e nëntëqindnëntëdhjetetë pikë tetëdhjeteshtatë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Punimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente, licensë për zbatim punimesh: Kategoria NP 1, Klasifikimi A, “Punime gërmimi në tokë”.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë autoritetit kompetent, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës” dhe nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punimeve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Kategoria NS-1, Klasifikimi A, Emërtimi “Punime gërmimi në tokë” është përcaktuar bazuar në objektin e prokurimit që është “Sistemimi i plazheve”. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 000 000 lekë, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Zëri i punimeve niveluse, ngarkimi dhe gërmimi me fadrom përfshin punimet e tokës që kërkojnë ekspertizë dhe licensë profesionale sipas kategorisë NP 1, Klasifikimi A, për punime gërmimi në tokë, që është kërkuar në kriterin 2.1.1 të kontratës. Ky zë tregon qartë kapacitetin teknik të operatorit ekonomik për të kryer punime të rëndësishme dhe specifike të terrenit, të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës dhe kërkojnë përdorimin e makinerive të specializuara si fadroma. Për operatorët e huaj, ky zë preventivi mund të përdoret për të evidentuar dhe njohur licencën profesionale të vendit të origjinës, në përputhje me kërkesat për njëhësim dhe vlerësim të vlefshmërisë së licencës për zbatimin e punimeve të kërkuara.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Faturat tatimore, të deklaruara në organet tatimore;*
- *Aktin e kolaudimit;*
- *Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.*

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Faturat tatimore, të deklaruara në organet tatimore;*
- *Akt kolaudimi objekti.*

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”, nenin 55, pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet...”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Këto vlera janë vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (a) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke

qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e punimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) persona, gjatë muajit Shkurt 2026.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- *Listëpagesës sipas formularit satandart për sigurimet për muajin Shkurt 2026.*
- *Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Shkurt 2026.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i punonjësve të nevojshëm është përcaktuar në bazë të orëve totale të punës të nxjerra nga preventivi, manuali i çmimeve të ndërtimit dhe analizat e kostove. Sasia totale e orëve të punës është 1,920 orë. Duke marrë parasysh një ditë pune prej 8 orësh, kjo përkthehet në 240 ditë pune ($1,920:8 = 240$). Afati i përcaktuar për realizimin e punimeve në grafikun e kontratës është 30 ditë kalendarike, prandaj për të realizuar punimet brenda afatit nevojiten 8 punëtorë në ditë ($240:30 = 8$). Duke përfshirë stafin drejtues si administratorin, inxhinierin e ndërtimit dhe drejtuesin teknik, është vlerësuar që operatori duhet të ketë 10 punonjës në total.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik që do të ndjekë punimet e kësaj kontrate, i cili gjatë zbatimit të kësaj kontrate nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga ky operator ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Operatori ekonomik kërkohet të përcaktojë një drejtues teknik të dedikuar për këtë kontratë, në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrje e vazhdueshme dhe profesionale gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve. Kërkesa që ky drejtues teknik të mos jetë i angazhuar njëkohësisht në kontrata të tjera lidhet drejtpërdrejt me nevojën për fokus maksimal, disponueshmëri të plotë dhe reagim të shpejtë ndaj problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit. Nëse drejtuesi teknik do të ishte i përfshirë në disa projekte njëkohësisht, do të rritej rreziku i mungesës së vëmendjes, vonesave në vendimmarrje dhe uljes së cilësisë së mbikëqyrjes teknike. Kjo mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e afateve, standardeve teknike dhe kërkesave kontraktuale. Ky kriter synon të mbrojë interesin publik duke siguruar që kontrata të realizohet me standarde të larta cilësie, efikasitet dhe përgjegjshmëri, duke minimizuar rreziqet që lidhen me menaxhimin e pamjaftueshëm teknik.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- *Certifikat e sistemit te menaxhimit te cilësisë ISO 9001:2015;*
- *Certifikat e sistemit te menaxhimit te mjedisit ISO 14001:2015;*
- *Certificate për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 ose ekuivalente*

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontatës së Bashkëpunimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Certifikata ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Kjo certifikatë tregon që operatori ka implementuar një sistem të standardizuar për menaxhimin e cilësisë, që përfshin procedura të dokumentuara për planifikimin, kontrollin dhe vlerësimin e punimeve. Në kuadër të sistemit të plazheve, kjo garanton që çdo aktivitet – nga nivelimi i terrenit, pastrimi i mbetjeve, deri te transporti dhe vendosja e elementëve të infrastrukturës plazhore – kryhet sipas standardeve të cilësisë, me monitorim të vazhdueshëm dhe korrigjime të menjëhershme kur është e nevojshme. ISO 9001:2015 siguron që punimet të jenë konsistente, me rezultat të parashikueshëm dhe me përputhje të plotë me specifikimet teknike të kontratës.

Certifikata ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Kjo certifikatë tregon që operatori ka zhvilluar dhe zbaton një sistem për menaxhimin e ndikimit mjedisor të aktiviteteve të tij. Në kontekstin e sistemit të plazheve, kjo përfshin menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e ndotjes së tokës dhe ujit, përdorimin e materialeve të përshtatshme dhe masat për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve të zonës bregdetare. ISO 14001:2015 garanton që të gjitha punimet të kryhen në mënyrë që të minimizohet ndikimi negativ në mjedis, duke respektuar legjislacionin dhe praktikat më të mira mjedisore.

Certifikata ISO 45001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Kjo certifikatë dëshmon që operatori ka krijuar një sistem të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve. Për projektin e sistemit të plazheve, kjo do të thotë që përdorimi i makinerive të rënda, fadromave, transporti i materialeve, punimet me eskavator dhe çdo aktivitet tjetër realizohen në mënyrë të sigurt. ISO 45001:2018 siguron që të gjitha masat parandaluese, procedurat për emergjencë, trajnimi i stafit dhe monitorimi i vazhdueshëm i kushteve të punës janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke reduktuar rrezikun e aksidenteve dhe dëmtimeve.

Ky kombinim certifikatash tregon që operatori ekonomik garanton ekzekutimin e punimeve në mënyrë profesionale, të sigurt dhe të qëndrueshme, me respekt të plotë për cilësinë, mjedisin dhe shëndetin e punonjësve.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organe të akredituara garanton besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre, duke siguruar që operatori ekonomik është audituar dhe përputhet realisht me standardet ndërkombëtare.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (mbi 10 ton)</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç me kapacitet mbajtës deri në 5 ton</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kokore</i>	<i>10 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kuti e ndihmës së shpejtë</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik;*
- siguracionin e mjetit.*

b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik,*
- siguracionin e mjetit.*

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkaëese.

- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- d) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.*
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i pajisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se shërbimet do të realizohen me cilësi.

Kamioni vetëshkarkues mundëson transportin dhe shpërndarjen efikase të materialeve të rënda dhe voluminoze, duke garantuar përmbushjen e punimeve brenda afateve të kontratës.

Eskavatori me zinxhir ofron kapacitet të lartë për gërmime, nivelime dhe manipulim të materialeve të tokës, duke mundësuar realizimin e terrenit sipas specifikimeve teknike për sistemimin e plazheve.

Autovinçi është i domosdoshëm për lëvizjen dhe vendosjen e objekteve ose materialeve të rënda në terren, duke siguruar siguri dhe efikasitet gjatë punës.

Përdorimi i kokores dhe kutisë së ndihmës së shpejtë garanton menaxhim të sigurt dhe të organizuar të punimeve dhe reagim të menjëhershëm ndaj situatave emergjente. Kjo pajisje dhe strukturë mjetesh tregon se operatori ka kapacitetin teknik dhe logjistik të nevojshëm për të kryer me sukses punimet e sistemimit të plazheve në përputhje me standardet e kërkuara.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia
1	Prerje bimë të vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$	m ²	5,050
2	Prerje e sistemim pemësh $\varnothing 10 \sim 20 \text{ cm}$	copë	480
3	Prerje e sistemim pemësh $\varnothing 21 \sim 40 \text{ cm}$	copë	150
4	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 9.0 km	m ³	2,820
5	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	2,915
6	Punime niveluse, ngarkimi, gërmimi me fadrom	op	98
7	Ngarkim, largim mbetje të rënda me autovinç deri në 5 ton	op	90
8	Punime me eskavator 0.5m ³	op	120

Realizimi i punimeve për sistemimin e plazheve përbën një tërësi ndërhyrjesh teknike dhe procese ndërtimore që synojnë përmirësimin e gjendjes fizike, funksionale dhe mjedisore të vijës bregdetare në zonat Himarë, Dhërmi, Jalë, Qeparo, Lukovë dhe Borsh. Punimet do të zhvillohen në kushte kantieri të përkohshëm, të organizuar sipas një plani pune dhe grafiku zbatimi të miratuar, duke respektuar standardet teknike të ndërtimit, normat e sigurisë në punë dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Në kuadër të këtyre punimeve parashikohen ndërhyrje në terren që përfshijnë pastrimin dhe sistemimin e sipërfaqeve ranore dhe shkëmbore, heqjen dhe largimin e mbetjeve urbane dhe inerte, si dhe përpunimin e sipërfaqeve përmes proceseve të gërmimit dhe nivelimit, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për përdorim publik dhe turistik. Punimet realizohen duke marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese të terrenit dhe duke ndërhyrë në mënyrë të kontrolluar për të ruajtur karakteristikat natyrore të zonës bregdetare.

Punimet e gjelbërimit dhe pastrimit përfshijnë prerjen e bimësisë së vogël me diametër deri në rreth 10 cm, si dhe prerjen dhe sistemimin e pemëve me diametër nga 10 deri në 20 cm dhe nga 21 deri në 40 cm. Këto punime kryhen në mënyrë selektive dhe të kontrolluar, duke respektuar kriteret mjedisore dhe duke garantuar ruajtjen e elementëve të rëndësishëm për stabilitetin e tokës dhe mbrojtjen nga erozioni. Materiali i përfituar nga prerjet grumbullohet, ngarkohet dhe transportohet jashtë kantierit në vendet e autorizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Punimet e dheut përbëjnë një komponent thelbësor të zbatimit dhe përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e materialeve të ndërtimit dhe dheut në distanca operative deri në 9.0 km dhe 10.0 km, në funksion të sistemimit dhe riformatimit të terrenit. Këto procese realizohen me mjete të përshtatshme transporti dhe në përputhje me kushtet teknike të rrugëve dhe terrenit, duke garantuar efikasitet dhe vazhdimësi të punimeve në kantier.

Në kuadër të zbatimit të punimeve përdoren mjete mekanike të specializuara si fadroma dhe eskavatorë me kapacitet rreth 0.5 m³ për realizimin e proceseve të gjelbërimit, nivelimit dhe ngarkimit të materialeve. Këto pajisje mundësojnë përpunimin e terrenit dhe arritjen e profileve të kërkuara sipas specifikimeve teknike. Në rastet kur në kantier paraqiten mbetje të rënda apo elemente voluminoze, kryhet ngritja, ngarkimi dhe largimi i tyre me autovinç me kapacitet deri në 5 ton, duke garantuar siguri gjatë operacioneve dhe shmangien e dëmtimeve në terren dhe infrastrukturë.

Të gjitha punimet realizohen në kushte të kontrolluara kantieri, me organizim të qartë të hapësirave të punës, sinjalistikë të përshtatshme dhe masa për mbrojtjen e punonjësve dhe të publikut. Gjatë zbatimit të punimeve merren masa për minimizimin e ndikimeve në mjedis, përfshirë kontrollin e pluhurit, zhurmave dhe menaxhimin e mbetjeve, si dhe për të shmangur ndërhyrjet e panevojshme në ekosistemin bregdetar.

Përfundimi i punimeve konsiderohet i realizuar kur sipërfaqet e trajtuara rezultojnë të pastra, të niveluara dhe të sistemuara sipas kërkesave teknike të projektit, duke garantuar funksionalitet, siguri dhe cilësi për përdorim publik dhe turistik. Operatori ekonomik mban përgjegjësi të plotë për zbatimin korrekt të proceseve ndërtimore, përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme, si dhe respektimin e të gjitha standardeve teknike, mjedisore dhe të sigurisë në punë gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve.

Punimet për prerjen e bimësisë së vogël me diametër deri në rreth 10 cm konsistojnë në ndërhyrjen e kontrolluar në terren për eliminimin e vegjetacionit të panevojshëm në sipërfaqet e plazhit, në zonat përreth dhe në segmentet e aksesit publik, me qëllim përmirësimin e kushteve funksionale, estetike dhe mjedisore të hapësirës bregdetare. Punimet realizohen në kushte kantieri dhe përfshijnë identifikimin në terren të sipërfaqeve që do të trajtohen, prerjen manuale ose mekanike në nivelin e tokës, grumbullimin e materialit bimor dhe largimin e tij jashtë kantierit. Procesi duhet të kryhet në mënyrë të kontrolluar duke shmangur dëmtimin e strukturës së tokës dhe të elementëve natyrorë me funksion mbrojtës ndaj erozionit. Materiali i prerë ngarkohet dhe transportohet në vendet e autorizuara për trajtim, ndërsa në kantier nuk lejohet depozitimi apo djegia e mbetjeve. Punimet konsiderohen të përfunduara kur sipërfaqja rezulton e pastër, e rregullt dhe e përshtatshme për përdorim publik, duke respektuar kërkesat teknike, mjedisore dhe të sigurisë në punë.

Punimet për prerjen dhe sistemimin e pemëve me diametër 10–20 cm konsistojnë në ndërhyrje selektive në gjelbërim, në funksion të sistemimit të hapësirës dhe rritjes së sigurisë në zonat e plazhit dhe aksesit publik. Punimet përfshijnë evidentimin dhe markimin e pemëve në terren,

prerjen e kontrolluar ose krasitjen sipas rastit, trajtimin e trunqeve dhe degëve, si dhe grumbullimin dhe largimin e materialit drusor nga kantieri. Në rastet kur kërkohet sistemim, ndërhyrja realizohet përmes krasitjes dhe reduktimit të kurorës duke ruajtur funksionin natyror të pemës. Punimet kryhen me mjete të specializuara dhe nën masa sigurie, duke përfshirë sinjalistikën dhe kufizimin e përkohshëm të aksesit në zonën e punës. Materiali i përfituar transportohet në vendet e autorizuara dhe zona lirohet nga çdo mbetje. Punimet konsiderohen të realizuara kur zona është e sigurt, e pastër dhe e sistemuar sipas kërkesave teknike.

Punimet për prerjen dhe sistemimin e pemëve me diametër 21–40 cm përfshin ndërhyrje më të avancuara në gjelbërim, duke kërkuar përdorim të pajisjeve të specializuara dhe organizim të kontrolluar të kantierit. Procesi përfshin markimin, prerjen e kontrolluar, menaxhimin e rënies së pemëve dhe përpunimin e materialit drusor, si dhe largimin e tij nga zona e punimeve. Në rastet e sistemimit, realizohen ndërhyrje për stabilizimin dhe formësimin e pemëve ekzistuese. Gjatë punimeve zbatohen masa të rrepta sigurie për mbrojtjen e punonjësve dhe të publikut, si dhe masa për mbrojtjen e mjedisit. Përfundimi i punimeve konstatohet kur zona është e liruar nga elementët e rrezikshëm dhe e sistemuar sipas kërkesave funksionale dhe estetike.

Punimet për transportin e materialeve të ndërtimit dhe dheut deri në distancë 9.0 km konsiston në organizimin e plotë të procesit të ngarkimit, transportit dhe shkarkimit të materialeve brenda kushteve të kantierit. Materialet përfshijnë dhe, rërë, mbetje inerte apo materiale të dala nga proceset e pastrimit dhe gërmimit. Ngarkimi realizohet me mjete mekanike ose manuale, ndërsa transporti kryhet me mjete të përshtatshme që garantojnë stabilitetin e ngarkesës dhe shmangin shpërndarjen e materialit gjatë lëvizjes. Shkarkimi realizohet në vendet e autorizuara. Gjatë gjithë procesit respektohen kërkesat teknike, rregullat e qarkullimit dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Punimi konsiderohet i përfunduar kur materiali është transportuar në mënyrë të sigurt dhe zona e kantierit mbetet e pastër dhe e rregullt.

Punimet për transportin e materialeve deri në distancë 10.0 km realizohet në të njëjtat kushte teknike, duke përfshirë organizimin e ngarkim-shkarkimit dhe transportin në distancë më të gjatë operative, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së proceseve të sistemimit dhe përpunimit të terrenit. Operatori mban përgjegjësi për zgjedhjen e itinerareve, menaxhimin e ngarkesës dhe respektimin e kërkesave mjedisore dhe të sigurisë gjatë gjithë procesit.

Punimet niveluese, ngarkimi dhe gërmimi me fadrom përfshijnë proceset mekanike të përpunimit të terrenit në kantier, duke synuar arritjen e niveleve dhe profileve të kërkuara sipas projektit. Procesi përfshin gërmimin e materialeve të papërshtatshme, shpërndarjen dhe nivelimin e materialit të dobishëm, si dhe ngarkimin e materialeve për transport. Fadroma duhet të jetë në gjendje të mirë teknike dhe të operohet nga personel i kualifikuar. Punimet realizohen duke respektuar kushtet e terrenit dhe duke shmangur dëmtimet në zonat përreth. Përfundimi i punimeve konstatohet kur sipërfaqja është e niveluar dhe e përgatitur sipas kërkesave teknike.

Punimet për ngarkimin dhe largimin e mbetjeve të rënda me autovinç deri në 5ton konsiston në operacione ngritjeje dhe transporti të elementeve voluminoze nga kantieri. Procesi përfshin identifikimin e mbetjeve, sigurimin e lidhjes me pajisjet ngritëse, ngritjen e kontrolluar dhe vendosjen në mjet transporti për largim. Autovinçi duhet të jetë i certifikuar dhe operimi të kryhet nga personel i licencuar. Zbatohen masa të rrepta sigurie dhe organizim i zonës së punës. Punimi konsiderohet i përfunduar kur zona lirohet nga mbetjet dhe është e sigurt për përdorim.

Punimet me eskavator me kapacitet 0.5 m³ përfshijnë gërmimin, zhvendosjen dhe sistemimin e materialeve tokësore në kantier, në funksion të përgatitjes dhe riformatimit të terrenit. Procesi realizohet në mënyrë të kontrolluar duke respektuar parametrat teknikë dhe kushtet e terrenit bregdetar. Materiali i nxjerrë përdoret për nivelim ose transportohet jashtë kantierit. Eskavatori duhet të jetë në gjendje të mirë teknike dhe të operohet nga personel i kualifikuar. Punimet konsiderohen të realizuara kur terreni është përpunuar sipas kërkesave dhe zona është e pastër dhe funksionale.

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

Nr	Përshkrimi i Punëve	10-ditëshi i parë	10 ditëshi i dytë	10 ditëshi i tretë
1.	Prerje bimë të vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$	+	+	
2.	Prerje e sistemim pemësh $\varnothing 10 \sim 20\text{ cm}$	+	+	
3.	Prerje e sistemim pemësh $\varnothing 21 \sim 40\text{ cm}$	+	+	
4	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 9.0 km	+	+	+
5	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	+	+	+
6	Punime niveluse, ngarkimi, gërmimi me fadrom	+	+	+
7	Ngarkim, largim mbetje të rënda me autovinç deri në 5 ton	+	+	
8	Punime me eskavator 0.5m ³	+	+	+

Ky grafik i punimeve paraqet një shpërndarje të mirëorganizuar të aktiviteteve përgjatë tre 10-ditëshave, duke reflektuar një planifikim efikas të burimeve dhe kohës. Në dy 10-ditëshat e parë vihet re përqendrim në prerjen dhe sistemimin e bimësisë (bimë të vogla dhe pemë me diametra të ndryshëm), si dhe në largimin e mbetjeve të rënda, çka tregon fazën fillestare të pastrimit dhe përgatitjes së terrenit. Ndërkohë, punimet që lidhen me transportin e materialeve, nivelimin, gërmimin dhe përdorimin e makinerive të rënda (fadromë dhe eskavator) shtrihen në të tre 10-ditëshat, duke siguruar vazhdimësi në procesin e ndërtimit dhe përpunimit të terrenit. Kjo shpërndarje tregon një koordinim logjik të fazave të punës, duke filluar nga përgatitja e terrenit deri te realizimi i punimeve kryesore.

NJËSIA E PROKURIMIT